

VENDIM
Nr. 63, datë 1.3.2021

**MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s, NË
LIDHJE ME MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PËRPUTHSHMËRISË SË
OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT PËR GAZIN NATYROR,
“ALBGAZ” SHA**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 91, pika 2 dhe të nenit 92, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE); Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 1.3.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 32/1 prot., datë 26.2.2021 të përparatë nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtoria e Gazit Natyror, “Mbi zgjatjen e vendimarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me miratimin e programit të përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për gazin natyror, “Albgaz” sh.a.”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 263, datë 28.12.2020, ka vendosur:

“- Të fillojë procedurën për miratimin e programit të përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për gazin natyror, ‘Albgaz’ sh.a.”.

- Në vijim të kësaj vendimarrjeje, janë lajmëruar palët e interesit për shprehjen e opinionëve të tyre në lidhje me fillimin e kësaj procedure, si dhe “Albgaz” sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 53 prot., datë 13.1.2021, ku i është kërkuar që të marrë në konsideratë konstatimet e vendimit të sipërcituar dhe të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës me qëllim përfundimin e procedurës.

- Pas korrespondencës së zhvilluar me “Albgaz” sh.a., rezulton se nuk është përditësuar ende programi i përputhshmërisë së “Albgaz” sh.a., me konstatimet e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 263/2020.

- Në nenin 91, pika 2, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: “Në mungesë të afateve të përcaktuara nga ligji i posaçëm, afati për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë.”.

- Në nenin 92, pika 1 dhe 2, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se:

“1. Përveç kur ndalohet shprehimisht nga ligji, në raste të justifikuara, për shkak të kompleksitetit të çështjes, organi publik mund të zgjasë vetëm një herë afatin e përcaktuar sipas nenit 91, të këtij Kodi.

2. Zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar.”.

- Në përmbushje të këtij afati, duke marrë në konsideratë faktin se shoqëria “Albgaz” sh.a. nuk është sqaruar ende plotësisht për përditësimin e konstatimeve të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 263/2020, në programin e përputhshmërisë, e mund të jetë e nevojshme dhe organizimi i një takimi virtual për këtë qëllim, duke pasur parasysh faktin që shoqëria është në fazën e përkthimit të programit, i cili duhet dërguar dhe për opinion të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, si dhe duke pasur parasysh dhe rrethanat kufizuese të krijuara për shkak të pandemisë COVID-19, vlerësohet të zgjatet afati i vendimarrjes së Bordit të ERE-s me 30 ditë pune.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s me 30 ditë, për miratimin e programit të përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për gazin natyror, “Albgaz” sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti